



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 231, datë 02.05.2024

**PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES SË KOMANDUAR
NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR ZNJ. MARINELA OSMANI
PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 10.02.2020-21.11.2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 68, 89 e vijues të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 159, datë 05.04.2023 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. Marinela Osmani, për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022”, i hartuar nga raportore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. Marinela Osmani, për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022”, duke e vlerësuar atë, si më poshtë:
 - A. Aftësia profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësia organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësia personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

PASQYRIMI DHE ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSIA PROFESIONALE

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të dokumenteve të hartuar, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, në mendimin e strukturës përgjegjëse organizative që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë punën e gjyqtarit të komanduar dhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit. Aftësia profesionale e gjyqtarit të komanduar pikëzohet, sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A Njohuritë ligjore

1.A.a Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë;

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor; Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

Referuar “Raportit përshkrues vjetor të punës”, rezulton se gjyqtarja e komanduar znj. Marinela Osmani ka ushtruar detyrën si Këshilltare Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kryesisht pranë Komisionit Disiplinor dhe Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit për periudhën 10.02.2020 – 10.02.2023. gjyqtarja e komanduar ka marrë pjesë në hartimin e disa akteve nënligjore si më poshtë vijon:

- Projekt-Vendimi “Mbi miratimin e rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.316, datë 14.09.2020 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.166, datë 16 Shtator 2020.
- Projekt-Vendimi “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, miratuar me vendimin nr.622, datë 10.12.2020.

- Projekt-Vendimi "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata", miratuar me vendimin nr.338, datë 24.09.2020.
- Projekt-Vendimi "Mbi miratimin e rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor", miratuar me vendimin nr. 558, datë 29.12.2022.
- Projekt-Vendimi "Mbi miratimin e rregullores "Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë", ende në procedurë.
- Projekt-Vendimi "Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019, "Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare", ende në procedurë.
- Projekt-Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe administratës së tij".

Gjatë periudhës së komandimit, është përkujdesur në hartimin dhe draftimin për herë të parë të projekt akteve që i përkasin procedurave disiplinore kryesisht të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bashkëpunim dhe me struktura të tjera të Këshillit, konkretisht të 14 (katërmbëdhjetë) procedimeve dhe 3 (tre) procedurave disiplinore.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, gjyqtarja e komanduar ka kryer procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, si dhe të pasurisë dhe figurës së 8 (tetë) kancelarëve në detyrë dhe 8 (tetë) kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit dhe këshilltarit ligjor.

Magjistratja kapërfaqësuar Këshillin në 16 procese gjyqësore.

- **Në "Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative",** lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se : Magjistratja e komanduar ka shfaqur aftësi të dukshme hulumtimi në drejtim të shqyrtimit dhe përpunimit në mënyrë tërësore të burimeve fizike dhe elektronike, me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore, në respektim të afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar për zhvillimin e këtyre procedurave disiplinore. Konkretisht, në afate shumë të shkurtra janë përgatitur projekt aktet që i përkasin fazave procedurale të ndryshme në Komision apo në Këshilli, që fillojnë nga momenti i depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe vijnë me projekt aktet për caktimin e relatorit të çështjes, njohjen me aktet e dosjes, procedurën e zhvilluar në Komision shoqëruar me projekt aktet përkatëse të tij, njoftimet procedurale të subjektit, projekt aktet për caktimin e seancës dëgjimore apo mbylljes së procedimit pa caktuar seancë dëgjimore, vijuar me përgatitjen e një relacioni paraprak për anëtarët e Këshillit dhe në përfundim përgatitjen e draftit të vendimit përfundimtar të arsyetuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke marrë në konsideratë të gjitha qëndrimet të gjithë anëtarëve, të mbajtura rreth rrethanave të faktit dhe ligjit të zbatueshëm gjatë kësaj vendimmarrje.

Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, në hartimin e këtyre projekt akteve ka identifikuar dhe zbatuar me saktësi dispozitat e Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe

Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratuar me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit, në drejtim të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, që ka të bëjë me qëllimin final të marrjes së një vendimi nga Këshilli brenda një afati të arsyeshëm, të dhënë mbi bazën e parimit të ligjshmërisë, “mosdënimit pa ligj”, parimin e akuzës, barazisë para ligjit, prezumimin e pafajësisë, proporcionalitetit, pavarësisë, paanësisë së institucioneve disiplinore etj.

Lidhur me përcaktimin e elementëve faktikë të çështjes për trajtim, në të gjitha procedurat disiplinore, magjistratja e komanduar referon në çdo rast në dokumentet dhe të dhënat e sjella në dosjen disiplinore, të administruara gjatë fazës së hetimit disiplinor nga ana e Inspektorëve përkatës, si dhe në të dhëna të tjera të cilat disponohen për magjistratin e proceduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për shkak të procedurave të tjera administrative apo nga burimet arkivore të tij (Këshillit). Spikat kujdesi i treguar i magjistrates për identifikimin e problematikave të veprimit të ligjit përsa i përket dispozitave që kanë lidhje me shkeljet disiplinore apo vendimmarrjet e natyrës procedurale, por dhe materiale të organeve proceduese.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes për trajtim, në të gjitha procedurat disiplinore, përkatësisht gjatë ndjekjes dhe hartimit të projekt akteve përkatëse, evidentohet aftësia dukshme e magjistrates në evidentimin e ligjit të zbatueshëm, referuar kohës së kryerjes së shkeljeve disiplinore, të pretenduara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pra konkretisht, kohës së dhënies së vendimeve gjyqësore objekt të procedimit disiplinor, në zbatim të parimit të mosdënimit pa ligj si dhe më pas në ekzistencën ose jo të shkaqeve të mjaftueshme, të bazuara në mënyrë të arsyeshme, në të dhënat e dala nga faktet dhe provat e mbledhura, për të besuar dhe vlerësuar nëse një shkelje disiplinore ka ndodhur ose jo, në zbatim të parimeve të ligjshmërisë, prezumimit të pafajësisë dhe dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor.

Magjistratja gjatë analizës së elementëve të ndryshëm proceduralë dhe materialë ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm si Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit, Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me përgjegjësinë disiplinore sipas këtij ligji; Rregulloren “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratuar me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit, Kodin e Etikës si dhe ligje dhe akte të tjera nënligjore në lidhje relevante me çështjen (p.sh. Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Procedurës Civile, Ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, etj).

Po kështu, magjistratja identifikon praktikë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë në analizën e gjetjeve në çështjet që i përkasin subjekteve të proceduara disiplinarisht, praktika të cilat aplikohen në drejtim të unifikimit të standardeve të mbajtura në procedura të ndryshme disiplinore, në funksion të interpretimit të drejtë dhe të njëjtë të dispozitave të

ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në drejtim të analizës së konfliktit të normave, magjistratja e komanduar ka shfaqur aftësi të dukshme hulumtimi për të identifikuar natyrën e çështjes në trajtim edhe vlerësimin e subjektit në përputhje me ligjin specifik të zbatueshëm si dhe konfliktin e normave procedurale dhe materiale. Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani ka shfaqur nivel të lartë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën. I kushton rëndësi përditësimit të këtyre njohurive, për të njohur dhe aplikuar pjesët e reja të legjislacionit, si dhe vendimeve unifikuese. Ajo ka aftësi të dukshme në hartimin e qartë të projekt akteve, në identifikimin e saktë të rrethanave të çështjes dhe ligjit të zbatueshëm.

Gjithashtu, gjatë procedurave administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve të pozicionit si dhe verifikimit të figurës dhe pasurisë të subjekteve të ndryshme, si kandidatë për magjistratë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë si dhe kancelarë në detyrë, por dhe në të gjitha procedurat e tjera administrative kur ajo është angazhuar nga strukturat përgjegjëse organizative, magjistratja ka treguar aftësi të larta në marrjen, administrimin e të dhënave/informacioneve të sakta nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë Këshillit, me qëllim realizimin në kohë të këtyre procedurave si dhe evidentimin e gjetjeve të rëndësishme apo elementëve të rëndësishëm faktikë në vlerësimin apo përmbushjen e kriterëve të ndryshme ligjore.

Lidhur me përfaqësimet në proceset gjyqësore magjistratja ka treguar kujdes të veçantë në paraqitjen sa më të plotë dhe të saktë të qëndrimeve të Këshillit në çështjet e shtruara për diskutim nga gjykatat gjatë këtyre gjykimeve dhe në veçanti, të gjetjeve të Këshillit në lidhje me vendimmarrjet e kontestuara nga subjekte të ndryshme proceduralë.

Në përfundim, lidhur me këtë tregues Struktura Përgjegjëse Organizative konkludon se: *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar znj. Marinela Osmani, në detyrën e këshilltares në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, ka treguar aftësi të larta për të evidentuar qartë, shpejt dhe saktë të dhënat, identifikon shumë qartë natyrën e çështjes, gjetjet konkrete dhe thelbësore në aktet e paraqitura në dosjen hetimore disiplinore apo në procedurat e tjera me natyrë administrative.*

Evidentimi i të dhënave kryhet prej saj saktësisht duke referuar në dokumentet dhe të dhënat e përftuara gjatë hetimit dhe shqyrtimit disiplinor të çështjes si dhe dokumenteve të paraqitura nga vetë subjekti i proceduar. Spikat aftësia e magjistrates për t'i përmbledhur dhe evidentuar elementët thelbësore që lidhen me analizën e gjetjeve. Evidentohet aftësia e saj e dukshme në përcaktimin e qartë dhe në mënyrë të shprehur të gjetjeve konkrete dhe thelbësore të cilat analizohen si veçmas ashtu dhe në tërësinë e tyre.

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes, gjetjeve konkrete dhe thelbësore në aktet e paraqitura nga subjektet procedurale apo burimet arkivore, lidhet me identifikimin e saktësisht prej saj të ligjit të zbatueshëm në drejtim të analizës së gjetjeve.

Magjistratja e komanduar Marinela Osmani ka shfaqur nivel të lartë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën. Identifikon dhe referon jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese, të GjEDNJ apo Gjykatës së Lartë lidhur me aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor. I kushton rëndësi përditësimit të këtyre njohurive, për të njohur dhe aplikuar pjesët e reja të legjislacionit si dhe të vendimeve unifikuese. Ajo ka aftësi të dukshme në hartimin e qartë të projekt akteve, në identifikimin e saktë të rrethanave të çështjes dhe ligjit të zbatueshëm. Shfrytëzon më së miri, burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke u shprehur se është dakord dhe nuk ka kundërshtime për vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative, dhe konkluduar se; *Vlerësimi i dhënë nga Struktura Përgjegjëse Organizative, në mendimin tim, është i plotë dhe i saktë në paraqitjen e të dhënave dhe analizimin e tyre dhe se vlerësimi i kryer është objektiv mbi bazën e analizës dhe gjetjeve për këtë tregues.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja e komanduar Znj. Marinela Osmani, këshilltare ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kryesisht pranë Komisionit Disiplinor dhe Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, gjatë periudhës së vlerësimit, ka marrë pjesë në hartimin e disa akteve nën ligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht në hartimin e Projekt-Vendimi “Mbi miratimin e rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr.316, datë 14.09.2020 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr.166, datë 16 Shtator 2020, Projekt-Vendimi “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, miratuar me vendimin nr.622, datë 10.12.2020, projekt-Vendimi “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”, miratuar me vendimin nr.338, datë 24.09.2020, Projekt-Vendimi “Mbi miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për kancelarin, këshilltarin dhe ndihmësin ligjor”, miratuar me vendimin nr. 558, datë 29.12.2022, Projekt-Vendimi “Mbi miratimin e rregullores “Për zhvillimin e procedurave disiplinore për nëpunësit e tjerë civilë gjyqësorë”, ende në procedurë, Projekt-Vendimi “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019, “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”, ende në procedurë, Projekt-Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe administratës së tij”. Gjithashtu, gjatë periudhës së vlerësimit është përkujdesur në hartimin dhe draftimin të 14 (katërmëdhjetë) projekt akteve të procedimeve disiplinore dhe 3 (tre) procedurave disiplinore. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, gjyqtarja e komanduar ka kryer procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, si dhe të pasurisë dhe figurës së 8 (tetë) kancelarëve në detyrë dhe 8 (tetë) kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit dhe këshilltarit ligjor.

Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, në hartimin e këtyre projekt akteve ka identifikuar dhe zbatuar me saktësi dispozitat e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratuar me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit, në drejtim të respektimit të së drejtës

për një proces të rregullt ligjor, që ka të bëjë me qëllimin final të marrjes së një vendimi nga Këshilli brenda një afati të arsyeshëm, të dhënë mbi bazën e parimit të ligjshmërisë, “mosdënimit pa ligj”, parimin e akuzës, barazisë para ligjit, prezumimin e pafajësisë, proporcionalitetit, pavarësisë, paanësisë së institucioneve disiplinore etj.

Lidhur me përcaktimin e elementëve faktikë të çështjes për trajtim, në të gjitha procedurat disiplinore, magjistratja e komanduar referon në çdo rast në dokumentet dhe të dhënat e sjella në dosjen disiplinore, të administruara gjatë fazës së hetimit disiplinor nga ana e Inspektorëve përkatës, si dhe në të dhëna të tjera të cilat disponohen për magjistratin e proceduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për shkak të procedurave të tjera administrative apo nga burimet arkivore të tij (Këshillit). Spikat kujdesi i treguar i magjistrates për identifikimin e problematikave të veprimit të ligjit përsa i përket dispozitave që kanë lidhje me shkeljet disiplinore apo vendimmarrjet e natyrës procedurale, por dhe materiale të organeve proceduese.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes për trajtim, në të gjitha procedurat disiplinore, përkatësisht gjatë ndjekjes dhe hartimit të projekt akteve përkatëse, evidentohet aftësia dukshme e magjistrates në evidentimin e ligjit të zbatueshëm, referuar kohës së kryerjes së shkeljeve disiplinore, të pretenduara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Magjistratja gjatë analizës së elementëve të ndryshëm proceduralë dhe materialë ka identifikuar dhe referuar ligjin e zbatueshëm si Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit, Ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me përgjegjësinë disiplinore sipas këtij ligji; Rregulloren “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratuar me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit, Kodin e Etikës si dhe ligje dhe akte të tjera nënligjore në lidhje relevante me çështjen (p.sh. Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi i Procedurës Civile, Ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, etj). Gjithashtu, në analizën e gjetjeve në çështjet që i përkasin subjekteve të proceduara disiplinorisht, gjyqtarja ka identifikuar praktikën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, praktika të cilat aplikohen në drejtim të unifikimit të standardeve të mbajtura në procedura të ndryshme disiplinore, në funksion të interpretimit të drejtë dhe të njëjtë të dispozitave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Gjithashtu, gjatë procedurave administrative të verifikimit të kushteve dhe kritereve të pozicionit si dhe verifikimit të figurës dhe pasurisë të subjekteve të ndryshme, si kandidatë për magjistratë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë si dhe kancelarë në detyrë, por dhe në të gjitha procedurat e tjera administrative kur ajo është angazhuar nga strukturat përgjegjëse organizative, magjistratja ka treguar aftësi të larta në marrjen, administrimin e të dhënave/informacioneve të sakta nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë Këshillit, me

qëllim realizimin në kohë të këtyre procedurave si dhe evidentimin e gjetjeve të rëndësishme apo elementëve të rëndësishëm faktikë në vlerësimin apo përmbushjen e kritereve të ndryshme ligjore.

Gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit ka përfaqësuar Këshillin në 16 procese gjyqësore, ku gjatë përfaqësimit ka treguar kujdes të veçantë në paraqitjen sa më të plotë dhe të saktë të qëndrimeve të Këshillit në çështjet e shtruara për diskutim nga gjykatat gjatë këtyre gjykimeve dhe në veçanti, të gjetjeve të Këshillit në lidhje me vendimmarrjet e kontestuara nga subjekte të ndryshme proceduralë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka aftësi shumë të mira për të shqyrtuar dhe përpunuar në mënyre tërësore burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore, për të përcaktuar elementët faktikë të çështjes për trajtim, për të identifikuar natyrën e saj, çështjet që shtrohen për zgjidhje, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se shkalla e aftësisë hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave është shumë e lartë dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Referuar “Raportit përshkrues vjetor të punës”, rezulton se gjyqtarja i komanduar gjatë ushtrimit të detyrës së këshilltares ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, përgjatë periudhës së vlerësimit 10.02.2020 - 21.11.2022, ka marrë pjesë në hartimin e 7 projektvendimeve për miratimin e akteve nënligjore të miratuara më pas nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe në hartimin e relacioneve përkatëse për këto projektvendime. Gjithashtu, ajo është përkujdesur në hartimin dhe draftimin për herë të parë të projekt akteve që i përkasin procedurave disiplinore kryesisht të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në

bashkëpunim dhe me struktura të tjera të Këshillit, konkretisht të 14 (katërmbëdhjetë) procedimeve dhe 3 (tre) procedurave disiplinore ndaj magistratëve. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe gjyqtarja ka kryer procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, si dhe të pasurisë dhe figurës së 8 (tetë) kancelarëve në detyrë dhe 8 (tetë) kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit dhe këshilltarit ligjor, duke hartur projektvendimet dhe relacionet përkatëse gjatë këtyre procedurave. Gjyqtarja e ka marrë pjesë edhe në disa komisione të përkohshme, duke ndihmuar në hartimin e akteve përkatëse në kuadër të veprimtarisë së komisioneve të përkohshme. Konkretisht, gjyqtarja ka ndihmuar në hartimin e disa akteve, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, për monitorimin dhe zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, të Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke kryer vlerësimin e statusit të magistratit për znj. Marsida Xhaferllari, ish-Kryeinpektore e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, për vitin akademik 2021-2022, të Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023, si dhe në kundër të Komisionit të Ekspertizës ngritur me vendimin nr.42, datë 21.06.2021 të Kryetares së Këshilli të Lartë Gjyqësor.

Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkruar vjetor të punës së gjyqtarës së komanduar, analizohet se; *Nga burimet e vlerësimit rezulton se magistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, në hartimin e projekt akteve, ka zbatuar paraqitjen e të dhënave dhe analizimin e tyre sipas formës standarde. Nisur nga natyra e akteve të hartuara nga magistratja e komanduar, evidentohet respektimi dhe zbatimi i saktë i parashikimeve të legjislacioneve të zbatueshme në varësi të natyrës së mosmarrëveshjeve të shumëllojshme të paraqitura për zgjidhje në Këshill. Magistratja në kryerjen e këtij procesi kujdeset të pasqyrojë qartësisht dhe saktësisht ligjin e zbatueshëm në çështjen konkrete, normat e aplikuara, parimet e së drejtës, jurisprudencën e brendshme dhe të jashtme, që ka lidhje thelbësore me çështjen e gjykuar. Në projekt aktet e hartuara prej saj, evidentohet një nivel i lartë interpretimi dhe zbatimi i ligjit material në funksion edhe të dhënies së përgjigjeve ezauruese, pretendimeve apo prapësimeve të subjekteve gjatë procedurave të ndryshme. Në të gjitha procedurat ku ajo është ngarkuar në cilësinë e këshilltares ligjore, nga ana e magistrates jepet një panoramë e qartë dhe e detajuar e ecurisë së çështjeve nga momenti i shortimit dhe ecuria e procedurës administrative, rrethanat e faktit, pretendimet e palëve, ligji i zbatueshëm, arsyetimi dhe në përfundim vendimmarrja e Këshillit.*

Identifikimi i normës juridike, si ligj i zbatueshëm në trajtimin e praktikave të ndryshme administrative si ato me natyrë disiplinore apo dhe të tjera, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me

interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale/procedurale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së çështjes.

Konkretisht, në mënyrë më specifike në procedurat disiplinore magjistratja, duke iu referuar natyrës së çështjes, përcakton edhe elementët që duhet të analizohen në aspektin e provueshmërisë së faktit, interpreton normën përkatëse të ligjit të posaçëm në mënyrë abstrakte, duke dhënë kuptimin e saj dhe duke evidentuar dhe analizuar elementët e shkeljes disiplinore konkrete, ku ky interpretim është i domosdoshëm. Interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të shkeljes përkatëse disiplinore si dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj.

Kryesisht, konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të Ligjit “Për Statusin”, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të shkeljes disiplinore përkatëse që i atribuohet magjistratit të proceduar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe në vijim, duke e përputhur atë me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të tij (magjistratit). Dispozitat e Ligjit Për Statusin analizohen në të gjithë elementët që lidhen me rrethanat e faktit, identifikimin e kuadrit ligjor të zbatueshëm në raport me rrethanat e faktit të provuara, identifikimin e shkeljes së kryer ose pa bazueshmërisë së pretendimeve të ILD për ekzistencën e saj, në vijim të rëndësisë dhe llojit të masës disiplinore, duke analizuar në mënyrë të veçantë llojin dhe rrethanat e shkeljes, shkallën e fajësisë dhe motivin, pasojën e ardhur nga shkelja, të dhënat profesionale dhe disiplinore të magjistratit, masën e ndonjë rreziku të shtuar nga shkelja disiplinore, sjelljen e magjistratit pas kryerjes dhe gjatë procedurave etj.

Konstatohet jo vetëm referimi por edhe interpretimi i dispozitave të ligjeve të posaçme, në ato raste kur dispozita materiale mbi shkeljet disiplinore referon si; Kushtetuta, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Ligji për rivlerësimin kalimtar, Kodi i Procedurave Administrative, Ligji Për Statusin, Ligji Për Pushtetin Gjyqësor, etj.

Në të gjitha procedurat burim vlerësimi magjistratja interpreton në mënyrë literale dhe sistematike dispozitat materiale me qëllim analizimin e elementëve të domosdoshëm në evidentimin ose jo të kryerjes së një shkelje konkrete disiplinore dhe në funksion të cilësimit juridik të saj si dhe të llojit të masës disiplinore që duhet aplikuar në rastet konkrete. Në të gjitha rastet, interpretimin e normave relevante, magjistratja nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar elementët ligjorë, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e grumbulluara dhe të marra në shqyrtim gjatë procedurës. Referuar provave ajo

konkludon në cilësimin juridik shkeljes dhe përgjegjësinë disiplinore të magjistratit të proceduar dhe llojit të masës disiplinore që duhet aplikuar.

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale magjistratja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, sipas burimeve të vlerësimit rezulton se magjistratja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (vendimet unifikuese dhe ato të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Ndërsa, në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e projekt akteve të analizuara, rezulton se gjyqtarja gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në të gjitha rastet, duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Në rastet kur çështjet në të cilat janë evidentuar gjetje paraqiten më komplekse, magjistratja identifikon referimin e dispozitave procedurale apo materiale, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, ndërsa analizon gjetjet sipas kriterëve ligjore.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar njëlloj si struktura përgjegjëse organizative dhe duke mos pasur kundërshtime për vlerësimin lidhur me këtë tregues. Konkretisht gjyqtarja ka shpjeguar se; *Gjatë draftimeve të akteve jam përpjekur në zbatimin dhe paraqitjen e të dhënave dhe analizimin sipas formës standarde, duke synuar gjithmonë në kompletimin e formës dhe përmbajtjes së mëtejshme të tyre (akteve) me elementë të rinj ligjorë dhe faktikë, të cilët duhet të individualizojnë rastin apo situata të caktuara të tij. Jam përpjekur të respektoj dhe zbatoj sa më qartë dhe saktë parashikimet e legjislacioneve të zbatueshme në varësi të natyrës së mosmarrëveshjeve objekt shqyrtimi në Këshill. Pra, në çdo rast jam munduar të mbaj një standard të lartë në pasqyrimin dhe analizimin e ligjit të.*

Detyra më e rëndësishme ka qenë identifikimi i normës juridike, si ligj i zbatueshëm në trajtimin e praktikave të ndryshme administrative, si ato me natyrë disiplinore apo dhe të tjera. Ajo është bërë në çdo rast në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, për të sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur me zbatimin e kësaj norme. Normat ligjore janë cituar duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Në të gjitha procedurat burim vlerësimi kam treguar impenjimin tim maksimal në interpretimin e normës duke thirrur në mënyrë konstante mënyra të ndryshme të interpretimit të saj si literal, sistematik, historik etj, me qëllim analizimin e elementëve të domosdoshëm në aplikimin e duhur të saj në rastet konkrete. Në çdo rast kam zbatuar si parimet dhe jurisprudencën e gjykatave më të larta, veçanërisht jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si dhe Jurisprudencën Unifikuese të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja e komanduar znj. Marinela Osmani në hartimin e projekt akteve në lidhje me procedurat disiplinore por edhe projekt akteve të hartuara gjatë procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, si dhe të pasurisë dhe figurës të) kancelarëve në detyrë dhe të kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit dhe këshilltarit ligjor, ka respektuar dhe zbatuar saktë parashikimet ligjore të zbatueshme në varësi të natyrës së mosmarrëveshjeve të shumëllojshme të paraqitura për zgjidhje në Këshill. Gjyqtarja është kujdesur jo vetëm të pasqyrojë qartësisht dhe saktësisht ligjin e zbatueshëm në çështjen konkrete, normat e aplikuara, parimet e së drejtës, jurisprudencën e brendshme dhe të jashtme, që ka lidhje thelbësore me çështjen e gjykuar por ka treguar në nivel të lartë në interpretimi dhe zbatimin e ligjit material në funksion edhe të dhënies së përgjigjeve ezauruese, pretendimeve apo prapësimeve të subjekteve gjatë procedurave të ndryshme.

Identifikimi i normës juridike, si ligj i zbatueshëm në trajtimin e praktikave të ndryshme administrative si ato me natyrë disiplinore apo dhe të tjera, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale/procedurale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së çështjes.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm në procedurat administrative me karakter individual, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, por dhe në përputhje me faktin dhe provat e mbledhura gjatë procedurës.

Kryesisht, konstatohet se gjyqtarja interpreton teorikisht normën relevante të Ligjit “Për Statusin”, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të shkeljes disiplinore përkatëse që i atribuohet magjistratit të proceduar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe në vijim, duke e përputhur atë me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të tij (magjistratit). Gjithashtu, gjyqtarja identifikon dhe interpreton edhe ligje të posaçme, në ato raste kur dispozita materiale mbi shkeljet disiplinore referon; si Kushtetuta, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Ligji për të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Ligji për rivlerësimin kalimtar, Kodi i Procedurave Administrative, Ligji Për Statusin, Ligji Për Pushtetin Gjyqësor, etj.

Në të gjitha procedurat burim vlerësimi magjistratja interpreton në mënyrë literale dhe sistematike dispozitat materiale me qëllim analizimin e elementëve të domosdoshëm në evidentimin ose jo të kryerjes së një shkelje konkrete disiplinore dhe në funksion të cilësimit juridik të saj si dhe të llojit të masës disiplinore që duhet aplikuar në rastet konkrete. Në të gjitha rastet, interpretimin e normave relevante, magjistratja nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar elementët ligjorë, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e grumbulluara dhe të marra në shqyrtim gjatë procedurës. Referuar provave ajo konkludon në cilësimin juridik shkeljes dhe përgjegjësinë disiplinore të magjistratit të proceduar dhe llojit të masës disiplinore që duhet aplikuar.

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale magjistratja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Gjithashtu, në burimet e vlerësimit evidentohet aftësia e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese dhe ato të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Ndërsa, në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e projekt akteve të analizuara, rezulton se gjyqtarja gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në të gjitha rastet, duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Në rastet kur çështjet në të cilat janë evidentuar gjetje paraqiten më komplekse, magjistratja identifikon referimin e dispozitave procedurale apo materiale, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, ndërsa analizon gjetjet sipas kritereve ligjore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Evidentohet kujdesi i magjistrates për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete. Spikat aftësia për të analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, faktet e çështjes së trajtuara, dhe siguron lidhjen e drejtpërdrejtë midis gjetjeve të konstatuara dhe dispozitave ligjore të zbatuara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se:

Nga burimet e vlerësimit rezulton se magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani në procesin e hartimit të projekt akteve të ndryshme si dhe zhvillimit të procedurave administrative, shfaq aftësi të larta për të shprehur mendimin e saj juridik, nëpërmjet përdorimit të fjalive të thjeshta, të kuptueshme, logjike, si dhe zbaton saktësisht rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, konstatohet përdorimi i të gjitha karaktereve të gjuhës shqipe (“ë” dhe “ç”). Nga ana e saj përdoren fjali me gjatësi të shkurtra ose mesatare, çfarë tregon kujdes të shtuar për të qenë sa më e qartë dhe e kuptueshme në aktet e hartuara prej saj, në funksion të perceptimit të tyre jo vetëm nga praktikantët e të drejtës.

Magjistratja i kushton vëmendjen e duhur strukturës formale, evidentimit të saktë të gjetjeve në procedura, formulimit të qartë dhe të saktë të të gjithë analizës së gjetjeve sipas përcaktimeve ligjore relevante, duke ndjekur me saktësi formën standarde të miratuar nga Komisionet dhe Këshilli. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit, gjithashtu.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme që përbëjnë dhe ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ndryshme me natyrë teknike.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine. Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsytimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të

jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke parashtruar se: *Kam shfaqur aftësi të larta për të shprehur mendimin juridik, nëpërmjet përdorimit të fjalive të thjeshta, të kuptueshme, logjike, dhe në zbatim të rregullave gramatikore dhe ato të sintaksës, duke përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe. Jam kujdesur të organizoj gjetjet duke ruajtur rrjedhën logjike të fjalisë në funksion të kuptueshmërisë së saj, si duke përdorur fjali me gjatësi mesatare, duke shmangur fjali nënrenditëse çfarë tregon kujdes të shtuar për të qenë sa më e qartë dhe e kuptueshme në aktin e hartuar nga ana ime në funksion të perceptimit të tij jo vetëm nga praktikantë të së drejtës. I kam kushtuar vëmendjen e duhur strukturës formale, evidentimit të saktë të gjetjeve në dosje, formulimit të qartë dhe të saktë të të gjithë analizës së gjetjeve sipas kriterëve përkatëse ligjore, në rastet e akteve individuale..*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se në procesin e hartimit të projekt akteve të ndryshme si dhe zhvillimit të procedurave administrative, gjyqtari e komanduar Marinela Osmani, shfaq aftësi të larta për të shprehur mendimin e saj juridik, nëpërmjet përdorimit të fjalive të shkurtra apo me gjatësi mesatare, të thjeshta, të kuptueshme, logjike, si dhe zbaton saktësisht rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës, duke përdorur të gjitha shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme që përbëjnë dhe ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ndryshme me natyrë teknike. Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine.

Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të projekt akteve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë, jo vetëm për subjektet proceduese por edhe çdo lexues të tyre. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit në çdo nënndarje të projek akteve të hartuara prej saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsytim çdo pjese të tij, sipas përmbajtjes. Dokumentet ligjorë të hartuar apo përpunuar nga gjyqtarja e komanduar janë të qartë, koncize dhe lehtësisht të kuptueshëm dhe të lexueshëm. Dallohet qartë përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, aftësia për të shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë, zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhja e kujdeshme e gjuhës dhe përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç),

organizimi i paragrafëve dhe i strukturës së fjalisë për të shprehur kuptimin si dhe përdorimi në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit“ vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumentave ligjorë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë::

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarës së komanduar, analizohet se: “Magjistratja i kushton rëndësi strukturës së mirë organizuar të projekt akteve sipas formës standarde të vendosur, duke i kushtuar rëndësi evidentimit të gjetjeve dhe identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të gjetjeve dhe analizës sipas kushteve dhe kriterëve të kërkuara nga ligjet e posaçme të zbatueshme sipas rastit. Të gjitha projekt aktet e përgatitura prej saj, paraqiten të organizuara sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen.

Në të gjitha projekt aktet e përgatitura prej saj ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm dhe është kujdesur në analizën e kontekstit të fjalëve. Paraqet në mënyrë kronologjike çështjet e trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projekt akteve. Përdor me saktësi konceptet profesionale, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nëndarje dhe paragrafe sipas rastit. Ka aftësinë e duhur për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale, aktet dhe i përdor ato në funksion të organizimit të punës. Grumbullon në kohë, gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përgatitjes së projekt akteve profesionale, si dhe dokumenton saktë çdo veprim të kryer prej saj.

Më përfundim struktura përgjegjëse organizative është shprehur se ; Në të gjitha rastet, projekt aktet e përgatitura nga ana e magjistrates znj. Marinela Osmani, janë miratuar nga struktura përgjegjëse organizative pa vërejtje të natyrës profesionale, tregues ky i cilësisë së lartë të hartimit të tyre, si në aspektin formal ashtu dhe substancial të dokumentit të hartuar nga magjistratja.

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se: *“ Kam treguar përkushtim për të mbajtur një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirë organizuar, në dokumentet ligjorë të hartuara dhe të përpunuara prej meje, strukturë të cilës i jam përmbytur me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit. Në draftimin e parë që iu është bërë akteve jam përpjekur të projektoj një metodologji të caktuar, sipas pjesëve përbërëse të dokumentit ligjor, apo sipas udhëzimeve të dhëna nga Komisioni përkatës apo anëtarë të Këshillit me eksperiencë të drejtim”.*

➤ **Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se** gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani i kushton rëndësinë e duhur strukturimit të projekt akteve sipas formës standarde të vendosur, duke i kushtuar rëndësi evidentimit të gjetjeve dhe identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të gjetjeve dhe analizës sipas kushteve dhe kriterëve të kërkuara nga ligjet e posaçme të zbatueshme sipas rastit. Të gjitha projekt aktet e përgatitura prej saj, paraqiten të organizuara sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen.

Në të gjitha projekt aktet e përgatitura prej saj ka identifikuar saktë ligjin e zbatueshëm dhe është kujdesur në analizën e kontekstit të fjalëve.

Gjyqtarja kujdeset në paraqitjen në mënyrë kronologjike çështjet e trajtuara sipas strukturës që përmban formati standard i projekt akteve, duke e ndarë mendimin në paragrafë dhe në nënpjesë, të evidentuara me fjali hyrëse përshkruese (nëntituj). Përdor me saktësi konceptet profesionale, duke strukturuar mendimin juridik me fjali të kuptueshme, dhe të organizuara në nëndarje dhe paragrafe sipas rastit.

Gjatë procesit të hartimit të projekt akteve, gjyqtarja ka grumbulluar në kohë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të përgatitjes së projekt akteve profesionale, si dhe ka dokumentuar saktë çdo veprim të kryer prej tij.

Rezulton se të gjitha Raportet e përgatitura prej saj, paraqiten të organizuara sipas standardeve të unifikuara në drejtim të çështjeve që trajtohen si dhe në të gjitha rastet, janë miratuar nga struktura përgjegjëse organizative pa vërejtje si në aspektin formal ashtu dhe substancial të dokumentit të hartuar, tregues ky i cilësisë së hartimit të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja i komanduar ka aftësi shumë të larta për të mbajtur një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirëorganizuar, në dokumentet ligjorë të hartuar/përpunuar prej saj, strukturë të cilës i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit. Ajo ndjek një metodologji të caktuar sipas pjesëve përbërëse të projekt aktit, apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit dhe kuptueshmërisë së përmbyajtjes së dokumentit. Gjyqtarës së komanduar nuk i është kthyer asnjë dokument ligjorë nga struktura përgjegjëse organizative për shkak

të gabimeve materiale apo për mospërputhje me metodologjinë e unifikuar apo strukturën e dakordësuar më parë, sipas rastit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës së komanduar në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, analizohet se: *“Në përmbajtjen e projekt akteve, projektrelacioneve dhe akteve të tjera administrative, konstatohet qartë se magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani ka aftësi për të analizuar konceptet, institutet dhe dispozitat që lidhen midis tyre. Ajo i kushton vëmendjen e duhur lidhjes logjike midis fakteve dhe çështjeve objekt analize dhe përfundimeve të arritura. Argumentimi ligjor mbi çështjet e trajtuara, ka përfshirë koncepte, institute juridike, por edhe parime të së drejtës, për aq sa ato kanë patur lidhje me thelbin dhe natyrën e çështjes objekt trajtimi. Gjatë analizës që i bëhet normës juridike, magjistratja zbërthen kuptimin e saj dhe sqaron lidhjen e saj me çështjen objekt trajtimi.*

Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj secilit projekt akt, si në aspektin formal ashtu dhe substancial nuk është evidentuar në asnjë rast mangësi në argumentimin ligjor apo mungesë logjike midis analizës së fakteve dhe përfundimit të arritur. Magjistratja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i përdorur në projekt akte është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të adresuara për zgjidhje.

Në përfundim struktura përgjegjëse organizative, duke e vlerësuar aftësinë e gjyqtarës si shumë të lartë, ka konkluduar se; *gjyqtarja e komanduar, shfaq aftësi të larta në paraqitjen e argumentit ligjor, në analizën e normës juridike, zbërthimit dhe kuptimit të saj në raport me çështjen e trajtuar. Spikat aftësia për të analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, çdo aspekt të procedurave të trajtim nga ana e saj përkundrejt analizës së kërkesave të ligjit.*

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke parashtruar se: *“Në projekt aktet e përgatitura nga ana ime kam shfaqur aftësi të larta për të analizuar konceptet, institutet dhe dispozitat që lidhen midis tyre, duke i kushtuar rëndësinë e duhur lidhjes logjike midis fakteve dhe çështjeve objekt analize dhe përfundimeve të arritura, në drejtim të cilësisë maksimale të analizës mbi bazën e një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore në dokumentet ligjorë të hartuar dhe përpunuar nga ana ime. Në të gjitha rastet, projekt aktet e përgatitura nga ana e ana ime janë miratuar nga struktura përgjegjëse organizative pa vërejtje të natyrës profesionale, tregues ky i cilësisë së lartë të hartimit të tyre, si në aspektin formal dhe të përmbajtjes së tyre.”*

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në përmbajtjen e projekt akteve të hartuara nga gjyqtarja e komanduar në Këshill, evidentohet qartë se ajo i kushton vëmendjen e duhur lidhjes logjike midis fakteve dhe çështjeve objekt analize dhe përfundimeve të arritura. Në argumentimin e saj ligjor mbi çështjet e trajtuara, ka përfshirë koncepte, institute juridike, por edhe parime të së drejtës, për aq sa ato kanë patur lidhje me thelbin dhe natyrën e çështjes objekt trajtimi. Gjatë analizës që i bëhet normës juridike, gjyqtarja i komanduar zbërthen kuptimin e saj dhe sqaron lidhjen e saj me çështjen objekt trajtimi.

Në asnjë rast, strukturat përgjegjëse organizative pranë së cilës ka punuar gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit nuk i ka kthyer për ripunim projekt aktet e hartuara prej saj, për mangësi në argumentimin ligjor apo për arsye të mungesës logjike midis analizës së fakteve dhe përfundimit të arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja e komanduar shfaq aftësi shumë të larta në paraqitjen e argumentit ligjor, në analizën e normës juridike, zbërthimit dhe kuptimit të saj në raport me çështjen e trajtuar. Spikat aftësia e gjyqtares për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim, duke i zbërthyer ato në raport me çështjen konkrete, duke arritur në konkluzionet përkatëse që vijnë si rrjedhë logjike e të gjithë arsyetimit ligjor. Në disa raste për të mbështetur interpretimin e saj ka referuar në qëndrimeve të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe atë të GJEDNJ. Në asnjë rast gjyqtares nuk i janë kthyer projekt aktet nga struktura përgjegjëse organizative për shkak të cilësisë të analizës dhe argumentimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtares së komanduar për treguesin *“Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”*, është *“Shumë e lartë”*, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

KRITERI	
AFTËSIA PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat pjesë e punës në Këshill. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur punon në autonomi, ashtu edhe në grup me të tjerë.

2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

2.A.a Aftësia për të realizuar volumin normal të punës

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Referuar “Raportit përshkrues vjetor të punës”,** rezulton se gjyqtarja e komanduar gjatë ushtrimit të detyrës së këshilltares në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor, *përgjatë periudhës së vlerësimit 10.02.2020 - 21.11.2022*, ka marrë pjesë në hartimin e 7 projektvendimeve për miratimin e akteve nënligjore të miratuara më pas nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe në hartimin e relacioneve përkatëse për këto projektvendime. Gjithashtu, ajo është përkujdesur në hartimin dhe draftimin për herë të parë të projekt akteve që i përkasin procedurave disiplinore kryesisht të filluara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bashkëpunim dhe me struktura të tjera të Këshillit, konkretisht të 14 (katërbëdhjetë) procedimeve dhe 3 (tre) procedurave disiplinore ndaj magjistratëve. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe gjyqtarja ka kryer procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, si dhe të pasurisë dhe figurës së 8 (tetë) kancelarëve në detyrë dhe 8 (tetë) kandidatëve për pranimin në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e ndihmësit dhe këshilltarit ligjor, duke hartur projektvendimet dhe relacionet përkatëse gjatë këtyre procedurave. Rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë edhe në disa komisione të përkohshme, duke ndihmuar në hartimin e akteve përkatëse në kuadër të veprimtarisë së komisioneve të përkohshme. Konkretisht, gjyqtarja ka ndihmuar në hartimin e disa akteve, në kuadër të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimesh lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, për monitorimin dhe zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, të Komisionit të Përkohshëm të Vlerësimit të Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të

ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke kryer vlerësimin e statusit të magjistratit për znj. Marsida Xhaferllari, ish-Kryeinpektore e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të veprimtarisë së Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, për vitin akademik 2021-2022, të Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023, si dhe në kundër të Komisionit të Ekspertizës ngritur me vendimin nr.42, datë 21.06.2021 të Kryetares së Këshilli të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë në disa procese gjyqësore ku ka qenë palë Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke e përfaqësuar atë në 16 (gjashtëmbëdhjetë) procese gjyqësore.

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *Referuar burimeve të vlerësimit si dhe të dhënave të Raportit përshkrues të punës, rezulton se magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, në periudhën e vlerësimit, ka përballuar një volum të lartë pune. Në cilësinë e Këshilltares Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, ka përfunduar dhe dorëzuar një numër të konsiderueshëm aktesh të ndryshme individuale, kolektive dhe nënligjore. Një kontribut të veçantë magjistratja ka dhënë në drejtim të draftimit të akteve të para të Këshillit, të dala për shkak të detyrimeve ligjore të rrjedhura nga Ligji “Për Statusin”, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë” etj. Kështu, ajo ka marrë pjesë në draftimin e akteve nënligjore, pjesa më e madhe të miratuara dhe aktualisht në fuqi.*

Gjithashtu, si pjesë e detyrës funksionale sipas pozicionit të komandimit, magjistratja ka marrë pjesë në të gjitha procedurat disiplinore të zhvilluara në Këshill gjatë periudhës së komandimit dhe ka kontribuar në hartimin e parë të të gjitha akteve standarde të Komisionit Disiplinor dhe Këshillit, gjatë këtyre procedurave. Po kështu, magjistratja e komanduar ka trajtuar 16 procedura me objekt verifikimin të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, si dhe të pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë, kandidatëve për këshilltarë ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë si dhe ndihmësve ligjorë në gjykatat e apelit. Edhe në lidhje me këto procedura nga ana e magjistrates, në bashkëpunim me kolegë të tjerë gjyqtarë ose jogjyqtarë, janë draftuar për herë të parë llojet e shkresave për marrjen e informacioneve të ndryshme nga institucionet e tjera shtetërore e publike, projekt aktet përkatëse administrative etj, në zbatim të detyrimeve që Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i ngarkohen nga vendimi i KLGJ-së me nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”.

Magjistratja e komanduar ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor në 15 procese gjyqësore, gjatë të cilave ka bashkëpunuar në mënyrë konsistente me struktura të tjera administrative në Këshill, me qëllim përgatitjen e qëndrimeve për aspekte të ndryshme procedurale dhe materiale të procesit. Përfaqësimet janë realizuara në

Gjykatën Administrative të Apelit si dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në këto procese gjyqësore, janë përgatitur prapësimet gjatë gjykimit por edhe konkluzione me shkrim, duke realizuar një mbrojtje profesionale dhe efektive përpara këtyre gjykatave.

Gjatë ushtrimit të këtyre detyrave magjistratja ka shfaqur impenjim maksimal në funksion të saktësisë dhe shpejtësisë së përzgjedhjes së akteve, ndërsa ka spikatur dhe kreativiteti i saj në zgjidhjen e situatave komplekse ligjore dhe faktike. Ajo ka treguar kujdes në administrimin e dosjeve të procedurave respektive, për faktin se procese administrative të tilla karakterizohen nga përparësitë e kërkuara Komisionet përkatëse dhe nga Këshilli.

Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani ka shfaqur përkushtim maksimal për përfundimin e projekt akteve në kohë sa më shpejtë të mundshme, pa cenuar në asnjë rast cilësinë e përmbajtjes së tyre. Bazuar në Raportin përshkrues statistikor të hartuar nga magjistratja e komanduar, rezulton se tej detyrave funksionale të hartimit të projekt akteve profesionale, ka kryer edhe detyra të tjera të cilat i janë ngarkuar asaj nga struktura të tjera organizative dhe administrative dhe përkatësisht për shkak të pjesëmarrjes në Komisione të përkohshme, grupe pune ose detyra të ngarkuara nga vetë Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë periudhës objekt vlerësimi, magjistratja ka marrë pjesë në 3 (tre) Grupe Pune të ngritura me urdhër të posaçëm nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- Grupi i përbashkët i punës për hartimin e rregullave për programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short, ngritur me urdhrin nr.11, datë 15.02.2022 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor,*
- Grupi i punës për përgatitjen e rregullave për ndihmësit ligjor, ngritur me urdhrin nr.31, datë 05.04.2022 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor,*
- Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave”, ngritur me urdhrin nr.80, datë 28.07.2022 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor .*

Po kështu, bazuar në burimet e vlerësimit, magjistratja ka marrë pjesë për shkak të anëtarit, në 4 (katër) Komisione të përkohshme, si vijon: Komisionit të Përkohshëm për hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisionit të Përkohshëm për hartimin e një plani veprimi lidhur me reduktimin e çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, për vitin akademik 2021-2022,- Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2022-2023, Komisioni i Ekspertizës ngritur me vendimin nr. 42, datë 21.06.2021 të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Krahas sa më lart, magjistratja e komanduar ka kryer detyra të veçanta të ngarkuara nga anëtarë të veçantë, si dhe detyra të caktuara në Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (për periudhat 30.09.2021 – 12.12.2021 dhe 13.09.2022 – 10.02.2023).

Magjistratja ka dhënë në mënyrë të pakushtëzuar kontributin e saj në zgjidhjen e situatave, të cilat për nga natyra e tyre kërkonin njohuri të posaçme profesionale dhe teknike. Referuar Raportit përshkues së punës të paraqitur nga magjistratja e komanduar, rezulton se në periudhën e vlerësimit ajo ka qenë e ngarkuar nga detyra të tjera që kanë në bëjnë me trajtimin e praktikave të ndryshme në kthimin e përgjigjeve kërkesave të personave të tretë, bazuar në të drejtën e tyre të informimit mbi veprimtarinë e kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Magjistratja e komanduar dhe dhënë kontribut të veçantë dhe në lidhje me përgatitjen e drafteve të deklaratave publike të Këshillit në mbrojtje të magjistratëve si dhe në raportimet e ndryshme mbi procedura me interes për publikun siç ishte dhe zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkruar vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtarja vlerësohet maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit, dhe situatës faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre, është shprehur aftësi e lartë në respektim të volumit dhe afateve për realizimin e punës, si dhe në aspektin procedural dhe saktësisë”*.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, ku pasi ka përshkruar volumin e punës së kryer prej saj, ka konkluduar se ka përballuar një ngarkesë të lartë punes, duke konkluduar njëjloj si me mendimin e strukturës organizative.

Në konkluzionet e saj mbi këtë tregues vetëvlerësimi gjyqtarja nuk ka bërë komente apo kundërshtime me mendimin e strukturës përgjegjëse organizative dhe administrative të dhënë për këtë tregues, duke i konsideruar ato të plota, të sakta, objektive dhe profesionale.

➤ **Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se** gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, në periudhën objekt i këtij vlerësimi ka përballuar një volum të lartë pune. Ajo, në cilësinë e këshilltares ligjore, në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka përfunduar dhe dorëzuar një numër të konsiderueshëm aktesh të ndryshme individuale, kolektive dhe nënligjore. Kështu, gjyqtarja ka marrë pjesë në të gjitha procedurat disiplinore të zhvilluara në Këshill gjatë periudhës së komandimit dhe ka kontribuar në hartimin e parë të të gjitha akteve standarde të Komisionit Disiplinor dhe Këshillit, gjatë këtyre procedurave, konkretisht të 14 (katërmëdhjetë) procedimeve dhe 3 (tre) procedurave disiplinore ndaj magjistratëve. Gjyqtarja e komanduar ka trajtuar 16 procedura me objekt verifikimin të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, si dhe të pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë, kandidatëve për këshilltarë ligjorë në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë si dhe ndihmësve ligjorë në gjykatat e apelit. Në këto procedura

gjyqtarja në bashkëpunim me kolëgët e tjerë ka drafuar për herë të parë një sërë shkresash për marrje informacioni nga organe shtetërore apo edhe në procedurat e ndjekura nga Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Gjithashtu, gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor në 15 procese gjyqësore, gjatë të cilave ka bashkëpunuar në mënyrë konsistente me struktura të tjera administrative në Këshill, me qëllim përgatitjen e qëndrimeve për aspekte të ndryshme procedurale dhe materiale të procesit, konkretisht janë përgatitur prapësimet gjatë gjykimit por edhe konkluzione me shkrim, duke realizuar një mbrojtje profesionale dhe efektive përpara këtyre gjykatave. Gjithashtu, gjyqtarja ka marrë në 3 (tre) Grupe Pune të ngritura me urdhër të posaçëm nga Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor si dhe për shkak të angazhimit të anëtarit përkatës në 4 (katër) Komisione të Përkohshme, ka marrë pjesë në hartimin dhe drafimin e akteve të nxjerra nga këto komisione.

Referuar mendimit të strukturës përgjegjëse organizative, rezulton se përgatitja e projekt akteve dhe dokumentave të tjerë me të cilat ka qenë e angazhuar gjyqtarja e komanduar, është një proces që kërkon realizimin e shumë veprimeve deri në finalizimin e tij dhe gjyqtarja e komanduar, Marinela Osmani, ka shfaqur gjithnjë një përkushtim maksimal gjatë procesit të hartimit e këtyre akteve dhe jo vetëm.

Përgatitja e projekt akteve është kryer në respektim të parashikimeve të: Ligjit Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, miratuar me vendimin nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit, ligjin ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, etj.

Në hartimin e projektrakteve, gjyqtarja i komanduar ka treguar një përkushtim të lartë, me qëllim që këto projekt akte, të përfundonin në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, por kurrësi pa cënuar cilësinë e përmbajtjes së tyre.

Bazuar në Raportin përshkrues statistikor të hartuar nga gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, rezultoi se ajo përveç hartimit të projektrakteve profesionale në kuadër të punës së Komisioneve të Përhershme por edhe të Përkohshme të Këshillit, ka kryer edhe detyra të tjera të caktuara, që kanë në bëjnë me trajtimin e praktikave të ndryshme në kthimin e përgjigjeve kërkesave të personave të tretë, bazuar në të drejtën e tyre të informimit mbi veprimtarinë e kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me përgatitjen e drafteve të deklaratave publike të Këshillit në mbrojtje të magjistratëve si dhe në raportimet e ndryshme mbi procedura me interes për publikun siç ishte dhe zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore.

Gjithashtu, siç u theksua më lart, gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, rezultoi se znj. Osmani, ka përfaqësuar Këshillin e Lartë Gjyqësor në 15 (pesëmbëdhjetë) procese gjyqësore ku Këshilli ka qenë palë, ku në ato procese gjyqësore, magjistratja ka përgatitur prapësimet por edhe konkluzionet me shkrim, duke realizuar një mbrojtje profesionale dhe efektive përpara gjykatës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera të përshkruara më sipër si pjesëmarrja në grupe pune, në procese drafitimi të akteve nënligjore, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave etj.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar për të realizuar ngarkesën e punës vlerësohet shumë e lartë dhe pikëzohet me 25 pikë.

2.A.b Aftësia për të respektuar afatet

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar;
- Mendim i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të saj duke analizuar se: “*Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, ka treguar përkushtim maksimal, për të përmbushur në kohën e duhur detyrat që i janë caktuar. Në hartimin e projekt akteve të ndryshme, magjistratja ka respektuar në çdo rast afatet e vendosura nga strukturat eprorë, por edhe afatet specifike të caktuara në detyrat e tjera, pa ceduar në asnjë rast në cilësinë e formës dhe përmbajtjes së tyre. Nuk është konstatuar asnjë problematikë në këtë aspekt të veprimtarisë profesionale të magjistrates së komanduar.*”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: “*Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit, dhe situatës faktike lidhur me kompleksitetin e çështjeve për trajtim, volumin e tyre, gjyqtari i komanduar ka realizuar në kohë reale dhe afate të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore detyrat e ngarkuara për trajtim, mbështetur në të dhëna të konstatuara*”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se; *Në aspektin e shpejtësisë së punës kam respektuar me përpikmëri dhe kujdes të shtuar afatet e caktuara nga Kryetarja e Këshillit, Relatori apo Komisioni si dhe ato të parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit. Vlerësoj se kam shfaqur aftësi të larta për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që më janë caktuar për trajtim.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar Z.Osmani, në hartimin e projekt akteve dhe detyrave të tjera të caktuara ka respektuar në çdo rast afatet e vendosura nga struktura eprore, Komisioni apo relatori i çështjes së trajtuar, afatet e përcaktuar në aktet nënligjore të Këshillit për kryerjen e procedurave të caktuara, duke mos ceduar në cilësinë e akteve.

Gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, ka treguar përkushtim maksimal, për të përmbushur në kohën e duhur edhe detyrat që i janë caktuar nga kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nga struktura përgjegjëse administrative, duke treguar kujdes maksimal.

Rezulton se nuk është konstatuar asnjë problematikë në këtë aspekt të veprimtarisë profesionale të magjistrates së komanduar.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të për respektuar afatet parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo atyre të caktuara nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative apo sipas rastit të natyrës së punës. Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja e komanduar ka aftësi shumë të mira për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që i janë caktuar për trajtim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të respektuar afatet”, vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

2.B Efektiviteti dhe metodologjia

2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarit të komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të saj duke analizuar se: *“Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar znj. Marinela Osmani, në detyrën e*

Këshilltares Ligjore në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme, ka shfaqur aftësi në qenien efektive në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprorë organizative dhe administrative në Këshill.

Me marrjen e detyrës së caktuar, shfaq qartësi në identifikimin e shpejtë të veprimeve të nevojshme për t'u kryer, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre, duke qenë efektive në menaxhimin e kohës dhe të burimeve të tjera në funksion të arritjes së një objekti në planet e punës të realizuar nga ana e saj.

Magjistratja shfaq aftësi në dallimin e çështjeve, trajtimi i të cilave ka përparësi dhe merr masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme. Në çdo rast është kujdesur në bashkëpunimin maksimal me anëtarët e Komisioneve pranë të cilëve ajo ka punuar, si dhe me anëtarët e tjerë të Këshillit, me strukturat përgjegjëse të Këshillit në funksion të përmbushjes në afat të detyrave të ngarkuara.

➤ *Si pjesëmarrëse në grupe pune, ka bashkëpunuar me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga urdhri përkatës i nxjerrë nga struktura eprorë.”.*

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”,** lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit është shprehur shumë e lartë aftësia për veprime procedurale, në shfrytëzim të kohës, burimeve në dispozicion, si dhe aftësia organizative”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke argumentuar se: *“...vlerësoj se kam aftësi në qenien efektive në realizimin e detyrave që më ngarkohen nga strukturat eprorë. Kam shfaqur qartësi në identifikimin e shpejtë të veprimeve të nevojshme për t'u kryer, por edhe kohën e nevojshme që duhet për përfundimin e tyre, duke qenë efektive në menaxhimin e saj dhe të burimeve të tjera në funksion të arritjes së një objekti në planet e punës të realizuar nga ana ime.*

Kam shfaqur aftësi në dallimin e çështjeve trajtimi i të cilave ka përparësi, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme. Kam shfaqur bashkëpunim maksimal me anëtarët e Komisioneve pranë të cilit kam qenë e caktuar, me anëtarët e tjerë të Këshillit, me strukturat administrative të Këshillit në funksion të përmbushjes në afat të detyrave të ngarkuara.

Si pjesëmarrëse në grupe pune, kam shfaqur gatishmëri maksimale me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga Urdhri përkatës i nxjerrë nga struktura eprorë përkatëse”

Edhe lidhur me këtë tregues gjyqtarja nuk ka bërë komente apo kundërshtime për vlerësimet e kryera nga struktura përgjegjëse organizative dhe ajo administrative, duke u shprehur dakord me vlerësimin e kryer.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me aspektet për vlerësimin e këtij treguesi rezulton se Znj. Osmani ka një eksperiencë relativisht të gjatë si gjyqtare e komanduar, fakt që i jep mundësinë që të jetë mjaft efektive në realizimin e detyrave që i ngarkohen nga strukturat eprore. Rezulton se gjyqtarja e komanduar i ka mjaft të qarta veprimet që duhet të ndërmarë kur njihet me detyrën që i është ngarkuar të kryejë, por edhe kohën e nevojshme që i duhet për përfundimin e tyre.

Gjyqtarja e komanduar është në gjëndje të dallojë çështjet, trajtimi i të cilave ka përparësi/ugjencë dhe të marrë masat për përfundimin sa më parë të tyre, duke shmangur çdo lloj vonese të panevojshme.

Gjithashtu, kur ka marrë pjesë në grupe pune, ka bashkëvepruar me kolegët, në funksion të përmbushjes në kohë dhe me cilësi të detyrave që burojnë nga urdhrat përkatës të nxjerrë nga struktura eprore.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të menaxhuar në mënyre efektive kohën dhe burimet e tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës, duke evidentuar çështjet që kanë përparësi trajtimi si dhe ato me probleme procedurale.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në treguesin “Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

2.C Rregullshmëria dhe saktësia

2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në “Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së

gjqtares së komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, si në rastin e hartimit të projekt akteve që i përkasin procedurave disiplinore apo administrative, ashtu edhe gjatë kryerjes së detyrave të tjera të ngarkuara nga strukturat drejtuese të KLGJ-së, është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar. Në çdo rast ajo shfaq kujdes të shtuar për të renditur aktet sipas kronologjisë së hartimit të dokumentit me qëllim qenien e tij lehtësisht i shfrytëzueshëm. Dokumentacioni pas përfundimit të punës që i është ngarkuar, është dorëzuar i plotë dhe në afatin e përcaktuar pranë strukturës kompetente”.*

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit”* si shumë të larta duke deklaruar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit është shprehur aftësi shumë e lartë rregullësie dhe saktësie në përpilim të dokumentacioneve, të cilat kanë qenë të shfrytëzueshme nga struktura kompetente”*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se: *“Si në rastin e hartimit të projekt akteve që i përkasin procedurave disiplinore apo administrative, ashtu edhe gjatë kryerjes së detyrave të tjera të ngarkuara, jam kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar, kam shfaqur kujdes të shtuar për të renditur aktet sipas kronologjisë së hartimit dhe përcjelljes në kohë të tij Relatorit dhe të gjithë anëtarëve të Këshillit. Dokumentacioni pas përfundimit të punës është dorëzuar i plotë dhe në afatin e përcaktuar pranë strukturës kompetente”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, si në rastin e hartimit të projekt akteve të ndryshme, ashtu edhe gjatë kryerjes së detyrave të tjera të ngarkuara nga strukturat drejtuese të KLGJ-së, është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar. Dokumentacioni pas përfundimit të punës që i është ngarkuar, është dorëzuar i plotë dhe në afatin e përcaktuar pranë strukturës kompetente.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta në renditjen e akteve dhe rregullshmërisë së dokumentacionit (fizik apo elektronik) të administruar, dokumentacion që gjyqtarja e komanduar i përcjell strukturës përgjegjëse ku ajo shërben sipas rastit ose strukturave të tjera të Këshillit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Raport përshkrues vjetor i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, pas evidentimit të të dhënave objektive të konstatuara në raportin përshkrues vjetor të punës së gjyqtarës së komanduar, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Nga të dhënat burimore, rezulton se magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani tregon kujdes maksimal në administrimin, mbajtjen, përcjelljen dhe mbikëqyrjen e dokumentacionit që i përket çështjes së trajtuar. Në dosjet përkatëse që i përkasin procedurave disiplinore apo administrative të trajtuara nga ana e saj, përfshihen ë gjitha aktet që kanë shërbyer për përpilimin e projekt akteve përkatëse.*

Magjistratja është kujdesur maksimalisht në mbajtjen dhe administrimin e rregullt dhe të plotë të dokumentacionit me të cilin ka punuar, dhe që ka lidhje me çështjen. Në asnjë rast nuk është evidentuar mangësi në dokumentacion, apo ngatërrim të praktikave të përcjella për trajtim”.

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Referuar veprimtarisë profesionale të gjyqtarit të komanduar gjatë periudhës së vlerësimit, dokumentacioni i hartuar dhe përgatitur ka qenë konkret, referuar për sa është kërkuar për trajtim” .*

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se ; *“Jam treguar maksimalisht e kujdesshme për t’i përcjellë strukturave përgjegjëse përkatëse ku kam ushtruar detyrën, një dokumentacion sa më të plotë dhe të saktë, i cili do t’i shërbente trajtimit të rastit, duke mos pasur asnjëherë mangësi apo ngatërrim dokumentacioni. Në çdo rast kam shfaqur kujdes të shtuar për të renditur aktet sipas kërkesave për trajtimin sa më efektive të tyre, pra për të qenë lehtësisht i shfrytëzueshëm, brenda një kohe sa më të shkurtër dhe duke mënjanuar çdo paqartësi të panevojshme”.* Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja nuk ka parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, ka administruar, mbajtur dhe mbikqyrur me mjaft kujdes dokumentacionin, aktet shkresore që përfshihen në të. Në dosje gjenden të gjitha aktet që kanë shërbyer për përpilimin e projekt akteve të ndryshme të realizuara prej saj në Komisione të ndryshme ku ka marrë pjesë. Aktet e dosjes kanë qënë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) i përcjellë strukturës përgjegjëse ku ai shërben apo strukturave të tjera të Këshillit, të jetë i plotë dhe t'i përkasë çështjes konkrete në trajtim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares së komanduar në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA ORGANIZATIVE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAve PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD;
- Të dhënat e raporteve të ILDKPKI.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, gjatë ushtrimit të detyrës, ka respektuar maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, por edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, por edhe përtej saj, nuk rezultojnë ndaj saj të jetë regjistruar ndonjë ankesë për mosrespektim të etikës, si nga eprorët, kolegët, stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor apo nga çdo person tjetër.*

Respektimi i normave të etikës nga ana e saj është vlerësuar dhe kuptuar, jo vetëm si një detyrim që duhet zbatuar gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë kohës së ushtrimit të saj. Nga të dhënat e raportit përshkues dhe ato të disponuara nga Këshilli nuk rezultojnë asnjë e dhënë apo indicie, e cila të dëshmojë për cenim të etikës në punë nga ana e gjyqtarës së komanduar”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar gjatë periudhës së vlerësimit ka shprehur dhe zbatuar në shkallë të lartë parimet e etikes, komunikimit, transparencës”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke argumentuar se *“Në lidhje me këtë tregues gjatë ushtrimit të detyrës kam treguar sjellje maksimalisht të kujdesshme, objektive, me vetëpërmbytje dhe maturi, në mënyrë korrekte, të ndërgjegjshme, sistematike dhe në kohë të arsyeshme, duke shmangur në mënyrë të ndërgjegjshme dhe me vërtetësi çdo sjellje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, duke mos u kufizuar vetëm me shmangien e sjelljeve që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin”.* Edhe lidhur me këtë tregues, gjyqtarja nuk ka parashtruar kundërshtime lidhur me vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, duke u shprehur dakord me vlerësimin e bërë nga strukturat përgjegjëse.

➤ Referuar informacionit të dërguar nga **Inspektori i Lartë i Drejtësisë** nëpërmjet shkresave nr. 2099/1 prot., datë 12.07.2023, protokolluar në Këshill me nr. 3619/3 prot., datë 13.07.2023, nr. 3339/1 prot., datë 18.12.2023, protokolluar në Këshill me nr. 3619/5 prot., datë 19.12.2023 dhe nr. 272/1 prot., datë 20.02.2024, protokolluar në Këshill me nr. 459/1 prot., datë 23.02.2024 është deklaruar arkivimi pas shqyrtimit fillestar për ankesat e paraqitura ndaj magjistrates Osmani

përgjatë periudhës së vlerësimit. Gjithashtu, për këtë periudhë, në ILD nuk është depozituar asnjë masë disiplinore nga organet kompetente.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezultojnë se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, gjatë ushtrimit të detyrës, ka respektuar maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, por edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi, por jo vetëm, nuk rezultojnë që në adresë të saj, të jetë regjistruar ndonjë ankesë për mosrespektim të etikës, si nga eprorët, kolegët, stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga subjektet e rivlerësimit apo nga çdo person tjetër. Respektimi i normave të etikës prej tij është vlerësuar dhe kuptuar, jo vetëm si një detyrim që duhet zbatuar gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe jashtë kohës së ushtrimit të saj.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja e komanduar reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezultojnë asnjë sjellje që mund të cënojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezultojnë se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit të komanduar

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD;
- Të dhënat e raporteve të ILDKPKI.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Lidhur me këtë aspekt vlerësimi, në detyrat që i janë ngarkuar për të kryer, magjistratja znj. Marinela Osmani ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e magjistratit. Në ushtrimin e detyrës së saj magjistratja ka demonstruar cilësi personale të mençurisë, ndjenjës së humanizmit, shfaqjes së guximit në dhënien e zgjidhjeve praktike situatave të papritura, duke patur gjithmonë në konsideratë se sjellja e saj profesionale dhe jo vetëm ndikon në imazhin e drejtësisë dhe besimit që publiku ka për organet e drejtësisë, përfshi Këshillin ku magjistratja ka qenë e komanduar.*

Në asnjë rast nuk është konstatuar që magjistratja të ketë shfaqur njëanshmëri në procedurat e ndjekura nga ana e saj, të ketë favorizuar, disfavorizuar, apo paragjykuar ndonjë prej tyre. Nuk është konstatuar asnjëherë, një sjellje jokorrekte apo e pahijshme e saj gjatë ushtrimit të detyrës.

Profesionalizmi, ndershmëria, përgjegjshmëria, respekti dhe vlerësimi për të tjerët, humanizmi, janë tipare thelbësore të karakterit të magjistrates znj. Marinela Osmani”.

- **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar për periudhën e vlerësimit ka shfaqur dinjitet të lartë duke ndjekur dhe zbatuar parimin e bashkëpunimit, me dinjitet, përgjegjshmëri dhe me vlera të larta personale”.*

- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se *“Gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar i komanduar kam respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës sime, duke shmangur çdo lloj shfaqjeje sjelljeje të pahijshme nderi dhe dinjiteti. Jam përpjekur maksimalisht t’i përgjigjem pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë e mia personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë, duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja ime në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut.*

Po kështu, gjatë detyrës sime jam përpjekur të shmang të gjitha paragjykimet të cilat shfaqin apo tregojnë qenien tim favor apo disfavor në lidhje me çështjet e shqyrtuara në Këshill. Jam përpjekur të transmetoj vlerat e mia personale dhe profesionale dhe të konsiderohem një model për të tjerët”.

- Referuar informacionit të dërguar nga **Inspektori i Lartë i Drejtësisë** rezulton se për periudhën 10.02.2020- 21.11.2022, ndaj gjyqtares Marinela Osmani, janë arkivuar të gjitha ankesat e paraqitura ndaj saj pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Po kështu, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtaren Marinela Osmani nuk është dhënë asnjë e tillë.

- Referuar raportit të **ILDKPKI**, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 72/23 prot. datë 15.05.2023, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, rezulton se: a) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c)*

nuk ka kryer fshehje të pasurisë; ç) nuk ka kryer deklaram të rremë; d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se në detyrat që i janë ngarkuar për të kryer gjyqtarës së komanduar, aja ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e gjyqtarit dhe nuk konstatohet në asnjë rast, të ketë shfaqur anësi në vlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, apo të ketë favorizuar ose paragjykuar ndonjë prej tyre.

Nuk është konstatuar asnjëherë, një sjellje jokorrekte apo e pahijshme e tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, referuar burimeve të vlerësimit si dhe parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja e komanduar duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi rezulton se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit e gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit të komanduar

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Vendimet përfundimtare për masat disiplinore brenda periudhës së vlerësimit;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave nga ILD.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke analizuar se: *“Lidhur me këtë aspekt vlerësimi, magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani shfaq kujdes në qenien e paanshme dhe në perceptimin nga të tretët të kësaj paanshësie, detyrim që duhet përmbushur në mënyrë të padiskutueshme.*

Në asnjë rast në aktet e hartuara nga ana e saj nuk rezulton të ketë dhënë konsiderata personale, ndërsa evidentohet të ketë mbajtur qëndrime tërësisht profesionale. Në aktet e përgatitura nga ana e saj tregon kujdes të shtuar në zgjedhjen e fjalëve dhe fjalive, duke shmangur çdo lloj fjale apo fjalie të papërshtatshme, me natyrë diskriminuese apo paragjykuese.

Nga të dhënat e burimeve në asnjë rast nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa për njëanshmëri në përmbushjen e detyrës. Nuk konstatohet përdorimi i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë, që të vënë në dyshim paanshësinë e saj në ushtrimin e detyrës.”.

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjyqtari i komanduar për periudhën e vlerësimit është mbështetur në parimet bazë të komunikimit, duke mos qenë diskriminues”.*

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtari të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se *“Në lidhje me këtë tregues në ushtrimin e detyrës dhe jashtë saj nuk kam përdorur asnjëherë gjuhë diskriminuese apo çdo lloj tendence tjetër për paragjykime. Asnjëherë qëndrimet e mia personale nuk kanë ndërhyrë në funksionin dhe detyrën e time jo vetëm si gjyqtar i komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.* Edhe lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është shprehur dakord për vlerësimin e bërë nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative, duke mos parashtruar asnjë koment lidhur me të.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara më sipër, rezulton se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin verbal ose përmbajtjen e dokumenteve ligjore të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e Raporteve apo dokumentave të tjerë të hartuar prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja e komanduar vlerësohet se ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit e gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: “Nga të dhënat e burimeve lidhur me këtë aspekt vlerësimi, rezulton se magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional dhe etik, në asnjë rast nuk ka kërkuar të heq dorë nga kryerja apo përmbushja e një detyre që i është ngarkuar nga eprorët, nga strukturat përgjegjëse organizative apo administrative në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Gjithashtu nuk rezulton të jetë paraqitur kërkesë për përjashtimin e saj nga procesi i zhvillimit të procedurave të ndryshme administrative. Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, gjatë ushtrimit të detyrës, ka respektuar maksimalisht normat etike, duke manifestuar sjellje korrekte si me eprorët, me kolegët, edhe me pjesën tjetër të stafit administrativ të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga të dhënat e raportit përshkues dhe ato të disponuara nga Këshilli nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje e cila të dëshmojë për cenim të etikës në punë nga ana e gjyqtarës së komanduar.

Magjistratja ka shfaqur integritet të lartë, ndershmëri, dinjitet, përgjegjshmëri, me qëllim përcjelljen e një imazhi sa më të mirë për figurën e magjistratit. Në ushtrimin e detyrës së saj magjistratja ka demonstruar cilësi personale të mençurisë, ndjenjës së humanizmit, shfaqjes së guximit në dhënien e zgjidhjeve praktike situatave të papritura, duke patur gjithmonë në konsideratë se sjellja e saj profesionale dhe jo vetëm ndikon në imazhin e drejtësisë dhe besimit që publiku ka për organet e drejtësisë, përfshi Këshillin ku magjistratja ka qenë e komanduar.

Në asnjë rast nuk rezulton të ketë paraqitur dorëheqje apo të jetë kërkuar përjashtimi i saj nga trajtimi i çështjeve të caktuara”.

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: “Gjyqtari i komanduar për periudhën e

vlerësimin, nuk ka refuzuar heqjen dorë nga trajtimi i procedurave administrative, në përputhje edhe me parimin e paanshmërisë”.

➤ Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar” gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se; “Gjatë ushtrimit të detyrës sime si gjyqtare e komanduar nuk kam patur asnjë rast për heqjen apo largimin/përrjashtimin tim nga kryerja e një detyre që më është caktuar nga Kryetarja, Relatori apo Komisioni”.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezultoi se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, gjatë periudhës objekt i këtij vlerësimi profesional dhe etik, në asnjë rast, nuk ka kërkuar të heqë dorë nga kryerja apo përmbushja e një detyre që atij i është ngarkuar nga eprorët apo nga strukturat përgjegjëse organizative apo administrative.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar për përjashtim si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarës së komanduar nga një procedurë administrative është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk është kërkuar asnjëherë përjashtimi i saj si dhe nuk ka hequr dorë nga asnjë procedurë administrative.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, si dhe atyre të refuzuara për heqjen dorë të gjyqtarit të komanduar nga një procedurë administrative”, rezulton ky numër është “I pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit të komanduar në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Lidhur me këtë aspekt vlerësimi, rezulton se magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të Këshillit.*

Komunikimi i saj karakterizohet nga përdorimi i fjalive të thjeshta, të qarta dhe konçize, transpartente dhe efektive në informacionin që kërkon të përcjellë. Magjistratja shfaq aftësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e bashkëbiseduesit, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me të.

Në çdo rast, komunikimi i saj ka qenë në respektim të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civile.”

➤ Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtari është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka shfaqur komunikim shumë të lartë. Ka qenë i qartë, kuptueshëm dhe transparent”.*

➤ Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Gjatë ushtrimit të detyrës kam patur një komunikim korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të Këshillit në respektim të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët dhe nëpunësit civil, duke dëshmuar aftësi për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe konçize”.*

Referuar burimeve të vlerësimit rezultoi se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim tejet korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së.

Komunikimi i saj karakterizohet nga përdorimi i fjalëve dhe fjalive të thjeshta, të qarta, duke shmangur përdorimin e fjalëve dhe fjalive që krijojnë keqkuptime, paqartësi apo kuptime të shumëfishta. Ajo shfaq aftësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e bashkëbiseduesit, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me të.

Gjithashtu në çdo rast, komunikimi i saj, ka qenë në respektim të plotë të normave etike të detyrueshme për gjyqtarët, por edhe në respektim të normave etike të detyrueshme për nëpunësit civilë.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja e komanduar në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani gjatë ushtrimit të detyrës, ka treguar kujdesin maksimal në përmbushjen e detyrimeve ligjore, lidhur me respektimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit, sa i takon të dhënave personale që ju përkasin subjekteve pjesëmarrëse në procedura të ndryshme disiplinore ose administrative, por edhe kategorive të tjera të zyrtarëve shtetërorë me të cilët ka ndërvepruar në përmbushje të detyrave të tjera që i janë ngarkuar atij nga strukturat drejtuese të Këshillit të Lartë Gjyqësor”*.
- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka respektuar parimin e konfidencialitetit duke ruajtur në mënyrë koncize çdo të dhënë konfidenciale”*.
- Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se *“Ky tregues është një aspekt i rëndësishëm i punës së gjyqtarit të cilin e ushtraj prej më shumë se 19 vjet. Besoj që e gjithë puna ime në Këshill është një karakterizuar nga kujdesi maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me të gjitha llojet e informacioneve dhe të dhënave për të cilat jam vënë në dijeni për shkak të trajtimit të proceduarve të ndryshme administrative”*.

KONKLZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja Marinela Osmani ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të procedimit apo vlerësimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari i komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendim i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani gjatë ushtrimit të detyrës, ka shfaqur gatishmëri maksimale për të bashkëpunuar me kolegët gjyqtarë ose jogjyqtarë në Këshill, si në planin njerëzor ashtu dhe profesional, duke treguar disponibilitet për të shkëmbyer me ta në çdo kohë njohuritë dhe përvojën e saj profesionale. Komunikimi i saj me kolegët ka qenë gjithmonë i hapur dhe i singertë.*

Komunikimi dhe bashkëpunimi korrekt, ka karakterizuar sidomos marrëdhëniet që magjistratja ka patur me stafin administrativ të Këshillit, gjatë ushtrimit të detyrave të saj në Këshill për shkak të pjesëmarrjes në Grupet e Punës, Komisionet e përhershme apo të përkohshme, në zhvillimin e procedurave të posaçme administrative, në përgatitjen e akteve nënligjore, në kthimin e përgjigjeve subjekteve të interesuara, në rastet e përfaqësimit të në procese gjyqësore etj.

Kontributi i dhënë nga magjistratja në komisionet dhe grupet e punës, sipas Raportit Përshkues të Punës ka qenë i rëndësishëm në plotësimin e kuadrit ligjor të

nevojshëm për zhvillimin e procedura të ndryshme në Këshill, të cilat kanë patur si qëllim standardizimin e procedurave që do të ndiqeshin në vijim nga strukturat organizative dhe administrative të Këshillit. Evidentimi i problematikave dhe dhënia zgjedhjeve e tyre ka qenë në fokus të vazhdueshëm të gjyqtarës.

Magjistratja ka shfaqur disponibilitet në përfshirjen e saj në grupet e ndryshme të punës sikundërse i liston në Raportin Përshkues dhe bashkëpunim për të ndarë me kolegët praktikant më të mira të punës.”.

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka shfaqur bashkëpunim dhe etikë, duke shkëmbyer përvojë profesionale”.*

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se: *“Në lidhje me këtë kriter kam treguar aftësi dhe disponibilitet për të bashkëpunuar me kolegët në ushtrimin e detyrës duke respektuar mendimet e tyre. Kam kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në ngritjen e problematikave mbi çështje të caktuara, si në përmirësimin e legjislacionit, diskutimin rreth zbatimit të vendimeve të Këshillit, hartimin e projekt akteve administrative dhe çdo çështje tjetër që lidhet me veprimtarinë time pranë Këshillit. Gjithmonë kam treguar gatishmëri për të ndarë me kolegët përvojën e përfutur në aktivitetet e ndryshme trajnuese”.*

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.*

4.B.b Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i komanduar ka qenë bashkëpunues, i gatshëm dhe efektiv edhe në detyra të ngarkuara edhe në pjesëmarrje në grupe pune duke dhënë kontributin maksimal”*.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se: *“Gjatë detyrës sime si gjyqtare e komanduar kam treguar gatishmëri të pakushtëzuar në dhënien e kontributit tim jo vetëm në lidhje me çështjet që trajtohen nga struktura përgjegjëse organizative ku kam shërbyer, duke mbuluar detyra të caktuara në katër Komisionet e përhershme të Këshillit, në Grupe pune, komisione të përkohshme, por edhe për çështje të tjera që lidhen propozime për ndryshime ligjore, përmirësimin e akteve të brendshme rregulluese të Këshillit, përfaqësimin gjyqësor të tij për çështje të veçanta jo të lidhura me punën Komisionit Disiplinor.”*

Referuar burimeve të vlerësimit, sikurse u përmend edhe më lart, rezulton se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, krahas kryerjes së detyrës në lidhje me hartimin e projekt akteve të të ndryshme gjatë procedurave disiplinore por edhe atyre të kualifikimit të ndihmësmagjistratëve apo të kancelarëve në detyrë të gjykatave, ka përfaqësuar KLGJ-në në 16 procese gjyqësore ku ajo është thirrur si palë e aditur si dhe ka përgatitur prapësimet dhe konkluzionet me shkrim. Gjithashtu, ajo ka marrë pjesë në draftimin e disa akteve nënligjore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të miratuara më pas nga Këshilli.

Gjithashtu, gjyqtarja i komanduar ka marrë pjesë në grupe pune të ngritura me urdhër të titullarit të KLGJ-së, ku ka dhënë ndihmën e saj profesionale në përmbushje të detyrave të caktuara nëpërmjet urdhrin përkatës etj.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë një deri dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarës së komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, vlerësohet se aftësia e saj në lidhje me këtë tregues duhet të pikëzohet maksimalisht, duke u pikëzuar me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat drejtuese të Këshillit” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse organizative;
- Mendimi i strukturës përgjegjëse administrative;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Mendimin e strukturave përgjegjëse organizative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij duke konkluduar se: *“Lidhur me këtë kriter vlerësohet se magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani, gjatë ushtrimit të detyrës, ka manifestuar një komunikim korrekt, të qartë dhe transparent, me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të Këshillit të të gjitha niveleve. Shfaq aftësi të larta komunikuese, respekton dhe vlerëson mendimin, qëndrimin apo opinionin e të tjerëve, edhe kur nuk ndan të njëjtin mendim apo opinion me ta. Komunikimi i saj me kolegët ka qenë gjithmonë i hapur dhe i sinqertë.*

Në çdo rast, komunikimi i saj ka qenë në respektim dhe harmoni të plotë të të gjitha normave etike si gjyqtare. Magjistratja ka treguar kujdesin maksimal në përmbushjen e detyrimeve ligjore, lidhur me respektimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit, sa i takon të dhënave personale që ju përkasin procedurave në trajtim nga ana e saj.

Magjistratja e komanduar znj. Marinela Osmani gjatë ushtrimit të detyrës, ka shfaqur gatishmëri maksimale për të bashkëpunuar me kolegët gjyqtarë të komanduar si dhe kolegët e tjerë jo gjyqtarë, duke transmetuar dhe shkëmbyer me ta njohuri të fushave të ndryshme si dhe përvojën e saj profesionale.

Pjesëmarrja e saj në Komisionet e ndryshme apo Grupet e Punës sipas Raportit Përshkrues të Punës tregon kontribut në çështje të ndryshme mbi performancën e sistemit gjyqësor, propozime për përmirësimin e tyre.

Ka shfaqur bashkëpunim dhe gatishmëri për zgjidhjen e situatave të caktuara, duke nxitur marrëdhëniet bashkëpunuese në Këshill në funksion të krijimit të një ambienti pune jo vetëm harmonik por dhe produktiv”.

- Në **“Mendimin e strukturës përgjegjëse administrative”**, lidhur me këtë tregues, gjyqtarja është vlerësuar maksimalisht duke konkluduar se: *“Për periudhën e vlerësimit, gjyqtari i*

komanduar ka qenë shumë bashkëpunues me strukturat funksionale, duke ofruar zgjidhje të mundshme me shfaqje të etikës profesionale”.

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke konkluduar se: *“ Jam e mendimit se kam treguar aftësi për të qenë bashkëpunues, për të reaguar me efikasitet në raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës, duke ruajtur qetësinë, etikën dhe duke synuar zgjidhjen e menjëhershme dhe efektive të konfliktit. Jam munduar të kem maksimalisht një marrëdhënie korrekte me anëtarët e Këshillit, strukturat drejtuese dhe administratën e Këshillit.*

Jam përpjekur për të shmangur maksimalisht situata konflikti, pasi në çdo rast kam ofruar zgjidhje alternative dhe efektive që i kanë paraprirë situatave të tilla. Kam patur dhe vazhdoj të kem marrëdhënie bashkëpunuese në Këshill, pasi në krijimin e tyre i kam kushtuar rëndësi ruajtjes së një ambienti harmonik dhe produktiv pune.”.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja e komanduar Marinela Osmani, gjatë ushtrimit të detyrës, në asnjë rast nuk ka krijuar situata konflikti. Bashkëpunimi i saj me eprorët, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me gjyqtarët e tjerë të komanduar dhe stafin administrativ të KLGJ-së ka qënë në nivele të larta.

KONKLuzioni

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e aftësisë për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë, është shumë e lartë. Gjyqtarja e komanduar është treguar e gatshme të japë kontributin e saj në raste të shfaqjes së problemeve apo vështirësive gjatë punës, duke ruajtur qetësinë, etikën dhe duke synuar zgjidhjen e menjëhershme dhe efektive të konfliktit. Gjyqtarja e komanduar ka ndërtuar marrëdhënie korrekte me anëtarët e këshillit, strukturat drejtuese dhe të gjithë administratën.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës së komanduar në lidhje me treguesin “Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet në rast nevojë” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

4.C Gatishmëria për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;

- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- Në **“Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja ka deklaruar se: *“Gjatë periudhës 10.02.2020 – 21.11.2022, kam marrë pjesë në 15 aktivitete trajnuese të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, gjithsej në 24 (njëzet e katër) ditë. Gjithashtu, kam marrë pjesë në një ëorkshop të organizuar nga EURALIUS me fokus trajnimin me praktikën e GJEDNJ-se për çështjet Disiplinore të Magjistratëve si dhe në Konferencën e organizuar në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor “Roli i institucioneve vetëqeverisëse të drejtësisë në forcimin e profesionalizmit dhe performancës së gjyqësorit”, zhvilluar në datë 1 Tetor 2021...”*

Si provë, magjistratja ka sjellë programin e konferencës *“Roli i institucioneve vetëqeverisëse të drejtësisë në forcimin e profesionalizmit dhe performancës së gjyqësorit”* së zhvilluar më datë 1 tetor 2021.

- **Nga të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës**, rezulton se gjyqtarja Marinela Osmani ka qenë në cilësinë e *pjesëmarrëses* në 15 (pesëmbëdhjetë) aktivitete, të zhvilluara gjithsej në 24 ditë kalendarike.

KONKLUZIONI

Në **tërësi**, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës por edhe jasht saj, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 15 aktivitete të zhvilluara për 24 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultoi se pjesëmarrja e gjyqtarës së komanduar në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës është brenda kufijve dhe për këtë arsye pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

➤ **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja ka deklaruar se: *“Në lidhje me këtë tregues, dua të theksoj se kam qenë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës të kandidatëve për magistratë që nga viti 2013 e në vijim.*

Përgjatë viteve 2020 – 2022, për shkak të komandimit, nuk jam angazhuar në mentorim të drejtpërdrejtë të kandidatëve për magistratë, por kam shprehur gatishmërinë time, duke qenë pjesë gjithnjë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës.

Kështu, kam qenë pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2019 – 2024, sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu, nga ana ime është vijuar dhe me trajnimin tim si mentore gjatë kësaj periudhe nga Shkolla e Magistraturës.

Gjithashtu, kam qenë pjesë e mësimeve në Programin e Formimit Fillestar përgjatë viteve akademike 2020 e në vazhdim, duke mbuluar tema të caktuara në fushën e së drejtës tregtare.

Kam qenë pjesë e një cikli trajnimesh për trajnerët për Lirinë e Shprehjes, kam përfunduar dhe jam certifikuar si trajnere në këtë fushë nga Shkolla e Magistraturës dhe Këshilli i Evropës, në kuadër të Programit të Përbashkët të Bashkimit - Evropian/Këshilli i Evropës “Lehtësitë horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019 -2022”.

Si provë, magistratja ka depozituar vendimet e Këshillit, përkatësisht Vendimin nr. 315, datë 22.07.2021 “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021-2024” dhe njoftimin e vendimit nr. 3500/3 prot, datë 26.07.2021 ku rezulton se vendimi i është njoftuar edhe gjyqtarës së komanduar si dhe Vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magistraturës viti akademik 2021-2022” dhe njoftimin e vendimit nr. 3500/3 prot, datë 26.07.2021 ku rezulton se vendimi i është njoftuar edhe gjyqtarës së komanduar.

Të dy vendimet rezultojnë që ia janë njoftuar magistrates së komanduar, por nuk rezulton që t’i jetë caktuar një kandidat magistrat për mentorim. Kjo për shkak se gjatë kësaj periudhe gjyqtarja është komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke mos ushtruar kështu veprimtari gjyqësore. Pra gjatë kësaj periudhe gjyqtarja e komanduar nuk ka dhënë kontributin e saj në mentorimin e magistratëve gjatë stazhin profesional dhe nuk ka qenë në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes në trajnimin e gjyqtarëve.

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit të komanduar, të gjithë e fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe një deri në dy pikë të tjera iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, nga relatorja u propozua se për gjyqtaren e komanduar Marinela Osmani, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzim maksimal, duke pretenduar se ; së pari, qenia si pjesë e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2019 – 2024, si dhe trajnimi i saj si mentore gjatë kësaj periudhe nga Shkolla e Magistraturës ; së dyti, pjesëmarrja saj në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magistraturës përgjatë viteve akademike 2020 e në vazhdim, duke mbuluar tema të caktuara në fushën e së drejtës tregtare,

dhe së treti, qenia pjesë e një cikli trajnimesh për trajnerët për Lirinë e Shprehjes, duke u certifikuar si trajnere në këtë fushë nga Këshilli i Evropës, në kuadër të Programit të Përbashkët të Bashkimit - Evropian/Këshilli i Evropës “Lehtësitë horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019 -2022”, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, janë të dhëna të cilat duhet të vlerësohet dhe njihen në kuadër të këtij treguesi dhe jo të treguesit “4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë”.

Pasi shqyrtoi edhe pretendimet e gjyqtares, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, Këshilli vlerësoi se për gjyqtaren e komanduar Marinela Osmani, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, apo për angazhimin e saj si udhëheqëse e kandidatëve për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja e komanduar nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues apo ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës.

Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares së komanduar dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **”Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja ka deklaruar se: “Angazhimet e mia në lidhje me këtë tregues nuk kanë qenë individuale për shkak të detyrës që unë kam ushtruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, pasi kontributi im në këtë drejtim ka qenë materializuar në vetë

veprimtarinë e ushtruar nga Këshilli gjatë kësaj periudhe. Dua të veçoj kontributin tim në këtë drejtim sidomos në draftimin e akteve nënligjore, të cilat janë marrë përsipër nga ana ime pavarësisht mungesës së një eksperiencë mëparshme në këtë fushë apo trajnimi të veçantë, detyra të cilat janë përballuar besoj me sukses nga ana ime.

Gjatë kësaj periudhe vlerësimi kam qenë anëtare e Bordit, e cila është një shoqatë e themeluar duke patur si qëllime kryesore (1) Promovimi dhe mbrojtja e vlerave si dhe i figurës së gjyqtarës grua; (2) Garantimi i aksesit të barabartë të grave gjyqtare në të gjitha nivelet e gjyqësorit si dhe promovimi në karrierë i tyre; (3) Ndërmarrja e nismave ligjore dhe pjesëmarrja aktive në procesin ligjvënës dhe në politikë bërje në rang kombëtar, në fusha që lidhen me të drejtat e gjyqësorit dhe të grave; (4) Mbrojtja e të drejtave dhe interesave të gjyqësorit dhe të grave në Gjykatën Kushtetuese dhe në institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare; (5) Zhvillimi i projekteve e aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare me qëllim rritjen profesionale të gjyqtareve dhe edukimin ligjor të kategorive të tjera të interesuara; (6) Promovimi i leadershipit në gjyqësor përmes edukimit dhe zhvillimit të rrjeteve mbështetëse gjyqësore; (7) Promovimi e qasja e barabartë në drejtësi e grupeve vulnerabël dhe sigurimi i drejtësisë dhe barazisë gjinore në sistemin tonë gjyqësor; (8) Promovimi i zgjedhjes dhe përparimit të grave gjyqtare, edukimi i publikut dhe i vendimmarrësve për rëndësinë e zgjedhjes së një gjyqësori të larmishëm, që pasqyron përbërjen e shoqërisë në përgjithësi, si dhe shmangien e pengesave për zgjedhjen dhe përparimin e tyre; (9) Edukimin dhe ndërgjegjësimin e të gjithë gjyqtarëve për faktorët shoqërorë, ekonomikë, psikologjikë dhe shkencorë që ushtrojnë ndikim negativ dhe shpërpjestimor te gratë dhe fëmijët në sistemin e gjyqësorit.

Gjatë periudhës objekt vlerësimi, nga Forumi, nën drejtimin e Bordit Drejtues dhe punës së tij, janë kryer aktivitete të shumta, ndër të cilat do të veçoja:

(i) Takimin e Bordit me anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor në datë 06.03.2020,

(ii) Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Forumit dhe Shkollës së Magjistraturës me objekt bashkëpunimin për zbatimin e aktiviteteve që lidhen me promovimin dhe mbrojtjen e vlerave si dhe të figurës së gjyqtarës grua dhe me qëllim rritjen profesionale të gjyqtareve dhe edukimin ligjor të kategorive të tjera të interesuara, promovimin e leadershipit në gjyqësor përmes edukimit dhe zhvillimit të rrjeteve mbështetëse gjyqësore, për promovimin e qasjes së barabartë në drejtësi e grupeve vulnerabël dhe sigurimi i drejtësisë dhe barazisë gjinore në sistemin tonë gjyqësor etj.

(iii) Realizimin e trajnimeve në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës me fokus çështjet gjinore;

(iv) Hartimin dhe propozimin e një Memorandumi Mirëkuptimi dhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor;

(v) Mbajtjen e një Konference Shkencore me fokus dhunën në familje, urdhrat e mbrojtjes, ngacmimin seksual dhe përndjekjen, mbajtur në datë 05.03.2021;

(vi) Anëtarësimi në Shoqatën Ndërkombëtare të Grave Gjyqtare;

(vii) Organizimi i një tryeze bashkëpunimi me Forumin e Grave Gjyqtare dhe Prokurore në Republikën e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal për

shkëmbimin e përvojave të ndërsjella sidomos përsa i përket përfaqësimit të grave gjyqtare dhe prokurore në sistemet gjyqësore respektive, mbajtur në datë 10-11 Qershor 2022 etj.

Si prova, magistratja e komanduar ka depozituar agjendën e tryezës së bashkëpunimit me Forumin e Grave Gjyqtare në Republikën e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal për shkëmbimin e përvojave të ndërsjella, zhvilluar me datë 10-11 qershor 2022 si dhe foto nga kjo veprimtari. Gjithashtu ka depozituar procesverbalin e takimit midis Bordit Drejtues të Forumit të Grave Gjyqtare Shqiptare dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor me mbështetjen e Projektit të USAID “Drejtesi për të gjithë” mbajtur me datë 06.03.2020, ku Znj. Osmani rezulton përfaqësuese e Bordit Drejtues.

Gjithashtu Znj. Osmani ka depozituar Vendimin nr. 33, datë 22.09.2020 ‘Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në programin e formimit fillestar për vitin akademik 2020-2021’ ku rezultojn pedagogje në dispozicion në lëndën ‘E drejtë tregtare’. Znj. Osmani ka depozituar pranë KLGJ Vërtetimin nr. 919/1 prot, datë 21.12.2023 lëshuar nga Shkolla e Magistraturës, protokolluar në Këshill me nr. 148 prot, datë 10.01.2024. Në këtë dokument vërtetohet angazhimi i Znj. Osmani pranë Shkollës së Magistraturës, në lëndën ‘E drejtë tregtare dhe e kompanive ».

Lidhur me këtë tregues në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se;”Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislativitetit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si (listë joshteruese): fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislativitetit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Në të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë ndërinstitucionale, duhet të provohet kontributi dhe angazhimi efektiv i gjyqtarit për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja e komanduar të ketë marrë pjesë në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, që konsiston në atë të mësimdhënie pranë Shkollës së Magjistraturës. Ndërsa në lidhje me angazhimin e saj në Shoqatën e Grave Gjyqtare Shqiptare, vetëm pjesëmarrja e gjyqtares në bordet e shoqatave dhe aktivitetet e mësipërme, nuk përbën veprimtari ndërinstitucionale.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren e komanduar Marinela Osmani, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në mësimdhënie.

Edhe për këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, jo për pikëzimin por për atë që konsiderohet veprimtari ndërinstitucionale, duke arsyetuar se kontributi i saj në trajnimin fillestar të kandidatëve për magjistrat, pra pjesëmarrja në mësimdhënie në Programin e Formimit Fillestar në SHM, të vlerësohet në kundër të treguesit “*4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve*”, dhe për këtë tregues të vlerësohet si kontribut pjesëmarrja e saj në Bordin Drejtues Forumin e Grave Gjyqtare Shqiptare, (organi i vetëm vendimmarrës i kësaj shoqate), dhe organizimi nga ana e Forumit, nëpërmjet Bordit tij, i një sërë aktivitetesh me fokus çështje të cilat lidhen drejtpërdrejtë me përmirësimin e sistemit gjyqësor. Ajo është shprehur se vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vlerësuar këtë kontribut duke organizuar me Bordin Drejtues një takim, zhvilluar në datë 06.03.2020, në të cilën ajo ka qenë prezent, kku janë trajtuar përpjekjet për të hartuar strategjinë afatmesme për vitin 2021-2023, duke i cilësuar nga Këshilli si një nga grupet e interesit që do të asistojnë në hartimin e kësaj strategjie, ku aty janë dhënë mendimet përkatëse për disa përmirësime në veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është propozuar dhe nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për të cilin është hartuar dhe komunikuar një draft paraprak, i cili nuk është finalizuar ende. Githashtu, gjatë veprimtarisë së tij Forumi ka patur në fokus dhe nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimit midis Forumit dhe Shkollës së Magjistraturës me objekt bashkëpunimin për zbatimin e aktiviteteve që lidhen me promovimin dhe mbrojtjen e vlerave si dhe të figurës së gjyqtares grua dhe me qëllim rritjen profesionale të gjyqtareve dhe edukimin ligjor të kategorive të tjera të interesuara, promovimin e lidershipit në gjyqësor përmes edukimit dhe zhvillimit të rrjeteve mbështetëse gjyqësore, për promovimin e qasjes së barabartë në drejtësi e grupeve vulnerabël dhe sigurimi i drejtësisë dhe barazisë gjinore në sistemin tonë gjyqësor etj. Në këtë kuadër janë realizuar trajnime në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës me fokus çështjet gjinore në Tiranë dhe rrethe. Po kështu, mbi bazën e disa vendimmarrjeve të Bordit Drejtues si dhe mbështetjen e

Projektit të USAID Drejtësi për të Gjithë, është mbajtur një Konferencë Shkencore me fokus dhunën në familje, urdhrat e mbrojtjes, ngacmimin seksual dhe përndjekjen, në datë 05.03.2021;

Anëtarësimi i Forumit në Shoqatën Ndërkombëtare të Grave Gjyqtare nga data 30.07.2020, është një arritje jo vetëm për objektin e veprimtarisë së Forumit, por dhe për njohjen të problematikave që shqetësojnë në nivel ndërkombëtar sistemet gjyqësore të shumë vendeve. Organizimi i një tryeze bashkëpunimi me Forumin e Grave Gjyqtare dhe Prokurore në Republikën e Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për zhvillimin e bashkëpunimit ndër rajonal për shkëmbimin e përvojave të ndërsjella sidomos për sa i përket përfaqësimit të grave gjyqtare dhe prokurore në sistemet gjyqësore respektive, mbajtur në datë 10-11 Qershor 2022 etj.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, Këshilli vlerësoi se gjyqtarja e komanduar gjatë periudhës së vlerësimit të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera, që lidhet me mësidhënien në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Ndërsa në lidhje me angazhimin e saj si anëtare e bordit drejtues të Shoqatës së Grave Shqiptare, vlerësoj se thjeshtë qenia e tillë nuk konsiderohet veprimtari ndër institucionale, por duhet të provohet kontributi konkret i gjyqtares në kuadër të përmirësimit të sistemit të drejtësisë.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit të komanduar dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë” rezulton angazhimi i gjyqtares së komanduar dhe për pasojë pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;
- Vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimi i tyre:

- **Në “Vetëvlerësimin e gjyqtarit të komanduar”** gjyqtarja ka deklaruar se: *“Në lidhje me këtë tregues nuk kam publikime ligjore të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN)”*.

Referuar burimeve të vlerësimit nuk rezulton se gjyqtarja e komanduar të ketë bërë publikime ligjore akademike.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, konsiderohen vlerë e shtuar për gjyqtarin e komanduar publikimet ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës. 1 deri 5 pikë caktohen për publikimet ligjore akademike, ku përfshihen artikuj, kapituj, monografi, ose publikime shkencore të tjera, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të shoqëruara me numër identifikimi (ISBN, ISSN).

Në këto kushte, vlerësoj se për gjyqtaren e komanduar Marinela Osmani, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarit, duke e pikëzuar me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit

1. Aftësia profesionale	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësia organizative	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësia personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja Marinela Osmani të vazhdojë të mbajë në konsideratë angazhimin e saj në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR